

**GJYKATA KUSHTETUESE SHQIPTARE SI NJË MJET ANKIMI EFEKTIV  
NË KUADËR TË KONVENTËS EUROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT  
NË LIDHJE ME MOSEKZEKUTIMIN E VENDIMEVE GJYQËSORE TË  
FORMËS SË PRERË**

**Elsa TOSKA DOBJANI\***

**Abstrakt:** Në këtë punim do të trajtohet një temë tepër delikate dhe e debatueshme mes juristëve, avokatëve dhe gjyqtarëve kushtetues që ka të bëjë me aspekte të përmirësimit të veprimtarisë së Gjykatës Kushtetuese, si mjet efektiv ligjor në kuadër të nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Pyetja që shtrohet në punim është se, a e plotëson kriterin e të qenit ‘mjet ankimi efektiv’ Gjykata Kushtetuese, në rastet e konstatimit të shkeljes së të drejtave të individit për shkak mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike? Problematika që ekziston në lidhje me efektivitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në kuptim të nenit 13 të KEDNj-së për çështje ku shtrohen pretendime në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si një element i procesit të rregullt ligjor, do të kërkonte një zgjidhje të situatës në përputhje me standartet e Strasburgut.

**Fjalët kyç:** Ankim efektiv, Gjykata Kushtetuese, mjet ligjor, zgjidhje.

**1. Evoluimi dhe interpretimi i termit ‘mjet ankimi efektiv’ sipas nenit 13 të KEDNj-së**

Nuk mund të lë pa përmendur në parantezë të kësaj analize, se neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj ose Konventë) është i lidhur ngushtësisht me parimin e interpretimit evolutiv të Konventës.<sup>1</sup> Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) e ka shndërruar pothuajse në një standart interpretues, por dhe argumentues shprehjen se ‘Konventa është një instrument i gjallë dhe duhet interpretuar nën dritën e kushteve aktuale jetësore.’ Sipas nenit 13 të KEDNj-së, çdokush të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në Konventë ka të drejtë të bëjë *ankim efektiv tek një organ i vendit të tij*, dhe kur shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.

GjEDNj në shumicën e vendimeve të saj është shprehur krahas shkeljes ose jo të neneve të tjera të Konventës edhe për nenin 13 dhe efektet e tij. Ajo që përbën një element të rëndësishëm të KEDNj-së, është se të gjitha të drejtat e përmendura në të, si e drejta e

---

\* Elsa Toska Dobjani, këshilltare ligjore, Gjykata Kushtetuese. Komentet dhe konkluzionet e këtij punimi janë vetëm të autores dhe nuk përfaqësojnë qëndrimet e Gjykatës Kushtetuese.

<sup>1</sup> Kjo nënçështje është prezantuar pjesërisht edhe në punimin E. Toska, ‘Avokati i Popullit si mjet ankimi efektiv në këndvështrim të nenit 13 të KEDNj-së’, Jeta juridike Nr. 2, 2005.

jetës, e drejta e lirisë, e drejta për një proces të drejtë gjyqësor, e të tjera, në strukturimin e saj, janë të përfshira nën rolin themelor të nenit 13 që luan rolin garant të të gjitha dispozitave të tjera të Konventës. Konkretisht me anë të nenit 13 të KEDNj- së, shtetet anëtare angazhohen që t'u japin individëve mundësitë për ankim efektiv për vënien në vend të shkeljes eventuale të të drejtave në fjalë. Gjithashtu është e rëndësishme të vëmë në dukje se GjEDNj ka arritur në përfundimin në shumë vendime të saj, se ekzistojnë rrethana të veçanta, të cilat e çlirojnë kërkuesin nga detyrimi i tij për të përdorur të gjitha mjetet ligjore vendase. Sipas saj, rregulli i shterimit të brendshëm të mjeteve ligjore nuk është as absolut dhe as nuk mund të zbatohet automatikisht.<sup>2</sup> Gjatë vlerësimit nëse janë ezauruar të gjitha mundësitë ligjore efektive nga gjykata, gjithmonë ka qenë e rëndësishme të përcaktohet se çfarë mjetesh sipas rastit kanë qenë në dispozicion të të fyerit/dëmtuarit dhe nëse ato i kanë krijuar ankuesit mundësi reale, por jo zhgënjyese, për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në mënyrë efektive.<sup>3</sup>

Në shqyrtimin e rasteve konkrete të lidhura me nenin 13 të Konventës, nga GjEDNj janë mbajtur parasysh këto elementë:

- (i) rrethanat e veçanta të secilit rast,
- (ii) rrethanat personale të kërkuesit,
- (iii) jo vetëm ekzistenca e mjeteve formale në sistemin ligjor të palëve kontraktuese, por edhe gjendja praktike, e përgjithshme ligjore, politike në të cilat ato zbatohen.

Si konkluzion, GjEDNj- ja ka pranuar se për efekt të nenit 13 të KEDNj-së, 'një ankim efektiv vendas' duhet të plotësojë këto kritere:

- (i) Të jetë mjet mbrojtës ligjor.<sup>4</sup>
- (ii) Të jetë mjet efektiv ligjor.<sup>5</sup> Gjykata është shprehur se mjeti ligjor i kërkuar nga neni 13 duhet të jetë efektiv si në praktikë dhe në ligj, veçanërisht në kuptimin që ushtrimi i tij të mos pengohet në mënyrë të pajustificuar nga veprimet ose mosveprimet e organeve të shtetit të paditur. Pra mjeti duhet të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.
- (iii) Organ i legjitimuar për individin që të ankohet.<sup>6</sup> GjEDNj është shprehur se Gjykata Kushtetuese Shqiptare do të konsiderohet mjet ankimi efektiv i

<sup>2</sup> Akdivar dhe të tjerë kundër Turqisë, vendim i datës 16.09.1996.

<sup>3</sup> Ugurlukoci kundër Republikës Federale Gjermane, vendim i datës 12.03.1987.

<sup>4</sup> Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 15.11.1996.

<sup>5</sup> Aksoy kundër Turqisë, datë 18.12.1996; Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë, datë 26.11.2000.

<sup>6</sup> Balliu kundër Shqipërisë, datë 30.11.2005.

brendshëm ligjor, për sa i përket kërkesave me objekt shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

- (iv) Autoritetet vendase duhet të japin zgjidhjen e duhur ligjore.<sup>7</sup> GjEDNj është shprehur se neni 13 lejon që jo vetëm autoritetet vendase kompetente të gjykojnë ankesat në bazë të Konventës, por dhe të japin zgjidhjen e duhur ligjore. Gjykata është shprehur se autoritetet e kërkuara në nenin 13 të KEDNj-së, jo domosdoshmërisht duhet të jenë autoritete gjyqësore, por nëse nuk janë të tillë fuqitë ligjore të tyre dhe garancitë që ato ofrojnë duhet të jenë efektive;
- (v) Organet vendase duhet të shprehen me vendim.<sup>8</sup>

Gjykata ka theksuar se neni 13 i Konventës garanton mundësinë e sigurimit në nivel kombëtar të mjeteve ligjore të mbrojtjes për zbatimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në KEDNj në çfarëdo forme që mund të jenë, nga ana e legjislacionit vendas. Në këtë mënyrë efekti i këtij neni është të kërkojë parashikimin e një mjeti mbrojtës vendas, duke i lënë hapësirë autoriteteve kompetente vendase, që të veprojnë në përputhje me dispozitat e parashikuara nga Konventa lidhur me ankesën si dhe të japin vendimin e përshtatshëm.

## 2. Gjykata Kushtetuese mjet ankimi efektiv sipas GJEDNj-së

Në përgjithësi mund të themi se roli dhe vendi i KEDNj-së në Kushtetutën tonë është i një rëndësie të veçantë. KEDNj është e inkorporuar në Kushtetutën Shqiptare dhe madje në disa prej dispozitave të saj, ne mund të konstatojmë pozitën e rëndësishme që i është dhënë, duke pasur dhe vetë një pamje më të qartë të pozicionit të saj krahasuar me Kushtetutën dhe legjislacionin vendas. Neni 17 i Kushtetutës me anë të paragrafit të dytë të tij arrin ta ngrejë KEDNj-në edhe mbi interpretimin e dispozitave të vetë Kushtetutës.<sup>9</sup> Porë në këtë këndvështrim, të drejtat e parashikuara në të kanë një ndikim të madh tek ligjvënësi, gjykatat dhe ekzekutivi. GJEDNj si autoritet interpretues i Konventës luan një rol vital në krijimin e jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese në përputhje me standartet e KEDNj-së. Në një farë mënyrë, në nivel kombëtar vendimet e GJEDNj-së kanë një lloj efekti *erga omnes*, sepse vërtet vendimi i GjEDNj-së është *inter partes*, por për raste të njëjta, jo domosdoshmërisht shteti shqiptar duhet të kalojë të njëjtin kalvar dhe çështja të përfundojë me gjykitjen e tij, prandaj dhe ky i fundit (përfshirë organet gjyqësore dhe ekzekutive) duhet të ketë parasysh efektet e vendimit për raste të njëjta.

<sup>7</sup>Soering kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 07.07.1989.

<sup>8</sup>Chahal kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 15.11.1996.

<sup>9</sup>Këto kufizime nuk mund të çënojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

GjEDNj ka analizuar në disa vendime, nëse Gjykata Kushtetuese është *mjet ankimi* në këndvështrim të nenit 35<sup>10</sup> të Konventës dhe a është *mjet ankimi efektiv* në këndvështrim të nenit 13 po të Konventës. Sipas parimit të subsidiaritetit,<sup>11</sup> individi do t'i drejtohet GjEDNj-së, në rast se ka ezauruar instancat kombëtare të ankimit prandaj dhe ia vlen të analizohet Gjykata Kushtetuese si mjet ankimi efektiv në përputhje me jurisprudencën e GjEDNj-së. Në çështjen *Cufaj & Co kundër Shqipërisë*, GjEDNj është shprehur se sistemi ligjor shqiptar ofron mjete juridike të brendshme, për të ankimuar një shkellje të së drejtës për një gjykim të drejtë, mundësi kjo që teorikisht ishte në dispozicion të shoqërisë ankuese.<sup>12</sup> Shoqëria u përpoq pa sukses ta shfrytëzonte këtë mjet, por Gjykata Kushtetuese e rrëzoi kërkesën e saj. Në këtë kuadër Gjykata vlerëson se e drejta për një proces të rregullt ligjor në Shqipëri duhej të ishte interpretuar në mënyrë të tillë që të garantonte një mjet juridik efektiv për shkelljet e pretenduara për mosrespektimin e kriterëve të nenit 6/1 të Konventës. Kështu në opinionin e GjEDNj-së, Gjykata Kushtetuese ishte kompetente të shqyrtonte kërkesën e shoqërisë ankuese në lidhje me mosekzekutimin e një vendimi të formës së prerë, si pjesë të juridiksionit të saj për të siguruar të drejtën për proces të rregullt ligjor.<sup>13</sup>

Në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë*, GjEDNj është shprehur se ajo është e mendimit se çështja e shterimit të mjeteve të brendshme ligjore është e lidhur ngushtë dhe kryesisht me çështjen e efektivitetit të ankimit kushtetues në lidhje me moszbatimin e një vendimi përfundimtar gjykatë, i cili është shqyrtuar sipas nenit 13.<sup>14</sup> Gjykata Europiane vë re se vendimet e Gjykatës Kushtetuese njohën se ka shkellje të së drejtës së ankuesit për qasje në gjykatë lidhur me moszbatimin e vendimeve të gjykatave të brendshme. Gjithsesi konstatimet e tyre ishin deklaruese, prandaj Gjykata Kushtetuese nuk ofroi ndonjë ndreqje adekuate. Veçanërisht ajo nuk akordoi ndonjë dëmshpërblim për dëme materiale dhe jo materiale, dhe as që mundi të ofrojë një perspektivë të qartë parandalimin e shkelljes të pretenduar ose vazhdueshmërinë e saj.<sup>15</sup>

GjEDNj ka përsëritur disa herë se ankimi para Gjykatës Kushtetuese të Shqipërisë është një nga mjetet që në parim duhet shfrytëzuar në lidhje me çështjet që lindin sipas nenit 6

<sup>10</sup> 'Gjykata mund të vihet në lëvizje vetëm pasi të jenë shteruar mjetet e brendshme ligjore, sipas kuptimit nga parimet përgjithësisht të pranuar të së drejtës ndërkombëtare dhe brenda një afati prej 6 muajsh nga data e vendimit përfundimtar të brendshëm.'

<sup>11</sup> Z dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar, vendim i datës 10.05.2001, par. 103; Kudła v. Poland, vendim i datës 26.10.2000, par. 152.

<sup>12</sup> Vendim i datës 18.11.2004.

<sup>13</sup> *Cufaj & Co kundër Shqipërisë*, para. 40-42.

<sup>14</sup> Vendim i datës 29.09.2009, par. 39.

<sup>15</sup> *Gjyli kundër Shqipërisë*, par. 58.

të KEDNj-së<sup>16</sup>, megjithatë në çështjen *Gjyli kundër Shqipërisë*, kjo gjykatë ka shkuar më tutje në analizën e saj, duke marrë në konsideratë dhe efektivitetin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, pa u mjaftuar vetëm me faktin se Gjykata Kushtetuese përbën mjet ankimi *de jure* sipas nenit 131/f të Kushtetutës.

### 3. Gjykata Kushtetuese ‘de facto’: Jurisprudenca dhe efektet e vendimeve

Në aspektin e procesit të rregullt ligjor Gjykata Kushtetuese ka kompetenca të kufizuara lidhur me të drejtën e saj për të shqyrtuar ankesat e individëve.<sup>17</sup> Gjykata Kushtetuese vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave të tyre kushtetuese për një *proces të rregullt ligjor*, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e këtyre të drejtave.<sup>18</sup> Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një *proces të rregullt ligjor*. Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.<sup>19</sup>

E drejta për një proces të rregullt ligjor është pasqyruar pothuajse në të gjitha elementët e saj në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese përfshirë dhe mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Kushtetuta parashikon në mënyrë të qartë karakterin detyrues të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese kanë fuqi detyruese, të përgjithshme dhe janë përfundimtare.<sup>20</sup> Natyra e disa vendimeve kushtetuese nuk kërkon kryerjen e veprimeve të mëtejshme nga organet përkatëse shtetërore (kur shfuqizohen dispozita ligjore dhe nuk lind nevoja e plotësimit të boshllëkut ligjor), por në raste të tjera organet shtetërore detyrohen të ndërmarrin veprime konkrete për të ekzekutuar vendimin e Gjykatës Kushtetuese. Këtë detyrim e gjejmë më evident në rastet e vendimeve që kanë konstatuar cënimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në organet gjyqësore apo çdo organ tjetër shtetëror.

Sipas këtyre vendimeve ekzekutimi konsiderohet i realizuar nëpërmjet rifillimit të procedurave ligjore në atë organ ku është konstatuar shkelja e të drejtave të individit për një proces të rregullt ligjor. Statistikisht, Gjykata Kushtetuese deri më tani ka dhënë 12 vendime me objekt konstatimin e cënimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.<sup>21</sup>

<sup>16</sup> Balliu kundër Shqipërisë, datë 09.11.2004; Cufaj & Co kundër Shqipërisë, datë 18.11.2004; Beshiri dhe të tjerë kundër Shqipërisë, datë 22.08.2006; Hysi kundër Shqipërisë, datë 26.02.2008.

<sup>17</sup> Sadushi S., Kontrolli Kushtetues, (Botimpex: Tiranë, Mars 2004), fq. 154.

<sup>18</sup> Neni 131/f i Kushtetutës.

<sup>19</sup> Neni 42 i Kushtetutës.

<sup>20</sup> Neni 132 i Kushtetutës.

<sup>21</sup> Kjo statistikë është e përditësuar me vendimet e GJK deri në datën 30 Korrik 2010. (Vendimi nr. 6, datë 31.03.2006; nr.27, datë 20.06.2007; nr. 43, datë 19.12.2007; nr.1, datë 19.01.2009; nr.8, datë 12.03.2009;

Deri në vitin 2006, Gjykata Kushtetuese nuk e konsideronte ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë si pjesë të procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Për pasojë kërkesat me objekt konstatimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor për shkak mosekzekutimi të vendimit gjyqësor të formës së prerë mbeteshin jashtë juridiksionit të kësaj gjykate, e cila merrte vendime *de plano* në të tilla raste. U desh vendimi *Qufaj & Co*, që të sillte ndryshime në jurisprudencën e kësaj gjykate.

Në këtë çështje, kërkuesi pretendonte shkelje të nenit 6 të KEDNj-së për shkak mosekzekutimi të vendimit gjyqësor nga organet e shteti shqiptar. GjEDNj e konsideroi pjesë të procesit të rregullt ligjor ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Nisur nga ky qëndrim i GJEDNj-së, nga Gjykata Kushtetuese u theksua në çështjet e mëpasme të saj, se mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë duhet të konsiderohet pjesë e procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së. Ky qëndrim është konsoliduar me disa vendime në vazhdimësi. Megjithatë këto vendime janë deklarative në kuptimin që ato edhe pse konstatojnë shkelje të nenit 42 të Kushtetutës dhe i deklarojnë ato, nuk arrijnë të vendosin detyrime për organet e shtetit për ekzekutimin e këtyre vendimeve ashtu si nuk arrijnë t'i caktojnë dëmshpërblim individit ndaj të cilit është kryer shkelja. Si të tilla ato janë të diskutueshme sa i përket efektivitetit të tyre në kuptimin që kërkon neni 13 i KEDNj-së, në aspektin *de jure* dhe *de facto*.

Vendimet e GJEDNj-së janë gjithashtu deklarative në natyrën e tyre, pra ato deklarojnë shkeljen e dispozitave të KEDNj-së.<sup>22</sup> Megjithatë kjo gjykatë i jep rëndësi parimit *restitutio in integrum*, sepse pasi shprehet se Konventa është shkelur, bazuar në nenin 41 të saj, ajo ka të drejtën e shpërblimit të drejtë të palës së dëmtuar, kur e drejta e brendshme mundëson vetëm ndreqjen e pjeshme të pasojave të shkaktuara nga shkelja. Nëse vërtetohet se ka pasur dëme, shteti duhet të paguajë shumën e përcaktuar në vendim. Gjykata vendos shpërblim financiar në të dyja rastet edhe për dëm moral dhe për dëm ekonomik.<sup>23</sup> Me vendimin nr.6/2006 Gjykata Kushtetuese është shprehur se:

Në të vërtetë Gjykata Kushtetuese, duke pasur edhe shumë kompetenca të tjera veç atyre të parashikuara në nenin 131 të Kushtetutës, është e detyruar të japë dhe vendime të llojeve të tjera, të ndryshme, pra dhe vendime konstatuese apo deklarative që në të vërtetë kanë efekte, pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret.

---

nr.9, datë 01.04.2009; nr.21, datë 21.07.2009; nr.6, datë 04.03.2010; nr.8, datë 23.03.2010; nr.13, datë 14.04.2010; nr.14, datë 15.04.2010, nr.23, datë 17.05.2010).

<sup>22</sup> Tom Barkhuysen, Michiel van Emmereik, dhe Piet Hein van Kempen, 'The execution of Strasbourg and Geneva Human Rights decisions in the national legal order', fq. 6.

<sup>23</sup> *Ibid*, fq. 8.

Kështu psh., Gjykata Kushtetuese vendos dhe për vërtetimin e pamundësisë së Presidentit të Republikës për të ushtruar funksionet e tij ose për zgjedhshmërinë dhe papajtueshmërinë në ushtrimin e funksioneve të tij dhe të deputetëve, si dhe verifikimin e zgjedhjes së tyre. Në raste të kësaj natyre dhe për të tjera si këto, Gjykata Kushtetuese merr vendime që kanë një natyrë tjetër nga ato për të cilat bëhet fjalë në nenin 132 të Kushtetutës.

...Pra, Gjykata Kushtetuese vendos nëse konstaton prekjën e një të drejte themelore nga organet që merren me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Pas kësaj, çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës, detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Sipas këtij vendimi, Gjykata pranon se mund të japë edhe vendime konstatuese apo deklarative që në të vërtetë kanë efekte, pavarësisht se nuk janë të natyrës që shfuqizojnë një akt konkret. Po në këtë vendim ajo shprehet se Gjykata Kushtetuese është një mjet ankimi efektiv për kërkesa me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore, përpara se individit t’i drejtohet GJEDNj-së. Gjithashtu ajo shprehet se çdo organ që ka detyrime nga vendimi përkatës, detyrohet të marrë masat e nevojshme për të ekzekutuar vendimin në mënyrë të plotë e të përpiktë me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile.

Megjithatë ende vendimet e Gjykatës Kushtetuese në lidhje me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, nuk janë efektive në kuptim të nenit 13 të KEDNj-së, pra të ofrojnë mundësi të qarta dhe të sigurt për rivënien në vend të së drejtës dhe të japin zgjidhjen e duhur ligjore. Ekzekutimi i vendimeve të GJK sanksionohet në nenin 81 të ligjit Nr. 8577, i datës 10 shkurt 2000, ‘Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë’, i cili rezulton me probleme në aspektin e zbatimit praktik të tij, sepse:

a) Neni 81 i ligjit që ngarkon Këshillin e Ministrave për t’u marrë me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nuk rezulton të ketë qenë dispozitë efektive.

b) E drejta e Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese për të dënuar me gjobë deri në 100 mijë lekë personat që nuk zbatojnë ose pengojnë zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, jo vetëm nuk i përshtatet funksionit të tij kushtetues, por nga ana tjetër nuk ka rezultuar të ketë qenë mjet efektiv për ekzekutimin e këtyre vendimeve.

c) Pavarësisht se ligji i ka njohur Gjykatës Kushtetuese të drejtën për të caktuar organin kompetent dhe përgjegjës për ta zbatuar vendimet e Gjykatës Kushtetuese, në praktikë nuk rezulton të jenë zbatuar rregulla të tilla proceduriale.<sup>24</sup>

<sup>24</sup> ‘Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës’, QSP/CPS, 2008, fq. 54.

Vendimet e deritanishme të GJEDNj-së, duhet të shërbejnë si nxitje për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese, me objekt konstatimin e cënimit të një procesi të rregullt ligjor, me qëllim shmangien sa të jetë e mundur të ndëshkimit financiar të shtetit shqiptar nga GJEDNj.

#### 4. Konkluzione

Parimi i subsidiaritetit kërkon që mjeteve efektive ligjore të sigurojë respektimin e të drejtave themelore të KEDNj-së në nivel kombëtar. GJEDNJ ka theksuar se paraqitja e ankesave në gjykatë, konform kriterëve të parashikuara nga legjislacioni i brendshëm duhet të bëhet para organit të duhur vendas, por kjo nuk kërkon që çështja të adresohet me anë të mjeteve që nuk janë të përshtatshme dhe efektive. Analiza e lartpërmendur u fokusua vetëm tek Gjykata Kushtetuese si një mjet ankimi efektiv në këndvështrim të nenit 13 të KEDNj-së në lidhje me konstatimin e cënimit të një procesi të rregullt ligjor për shkak mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Tashmë mund të thuhet se Gjykata Kushtetuese ka kompetencën të vendosë për çështje me objekt mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhunim i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi individit i kanë shteruar të gjitha rrugët e ankimit.

GJEDNJ ka vlerësuar se Gjykata Kushtetuese mund të konsiderohet një mjet ankimi, dhe duhet të ezaurohet si i tillë kur pretendohet dhunim i së drejtës së ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Megjithatë me vendimin *Gjyli kundër Shqipërisë*, kjo gjykatë i ka konsideruar joefektive vendimet deklarative të Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e cënimit të një procesi të rregullt ligjor, për shkak mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Në praktikë, Gjykata Kushtetuese mbetet *një mjet ankimi jo efektiv* lidhur me mosekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë nga organet e administratës publike, si element i procesit të rregullt ligjor në përputhje me nenin 42 të Kushtetutës, sepse nuk ofron ndreqje të shkeljes ose pasojave të shkaktuara nga shkelja.

Në mënyrë që Gjykata Kushtetuese të plotësojë kriteret e të qenit një *mjet ankimi efektiv* në këndvështrim të nenit 13 të KEDNj-së për çështje me objekt konstatimin e cënimit të procesit të rregullt ligjor për shkak mosekzekutimi të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, duhet që ligjvënësi t'i japë shumë më tepër hapësirë kompetencave të kësaj Gjykate. Në këtë drejtim, do të sugjerohet ndryshime në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese që përcaktojnë rregulla më të plota dhe të qarta që i japin të drejtën asaj edhe për caktimin e dëmshpërblimeve për individët në raste të konstatimit të shkeljes së të drejtave të tyre, si dhe krijimin e një organi të posaçëm monitorues për ekzekutimin e vendimeve të kësaj natyre, por edhe të vendimeve të tjera që mund të shfaqin probleme mosekzekutimi.



**BIBLIOGRAFI**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese (2006-2010)

Jurisprudencë e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut

Ekzekutimi i vendimeve të Gjykatës Kushtetuese dhe roli i tyre në forcimin e shtetit të së drejtës, QSP/CPS, Tiranë 2008

Tom Barkhuysen, Michiel van Emmereik, Piet Hein van Kempen, ‘The execution of Strasbourg and Geneva Human Rights decisions in the national legal order’, Martinus Nijhoff Publishers, 2006

Traja. K., ‘Papajtueshmëritë e praktikës gjyqësore shqiptare me standartet minimale të Konventës’ (Kumtesë konferenciale)

Toska. E., ‘Avokati i Popullit si mjet ankimi efektiv në këndvështrim të nenit 13 të KEDNj-së’, Jeta juridike nr.2, 2005, botim i Shkollës së Magjistraturës

Sadushi S., Kontrolli Kushtetues, Botimpex, Tiranë, Mars 2004

**THE ALBANIAN CONSTITUTIONAL COURT AS AN EFFECTIVE REMEDY  
IN THE LIGHT OF THE ECHR**

**Abstract:** This article deals with a very delicate issue, widely argued in round-tables of lawyers and constitutional judges, namely the legal difficulties encountered in bringing the Albanian constitutional standards in line with the standards laid down by the European Convention of Human Rights. The European Convention of Human Rights as an international treaty is part of Albanian legal system. The Constitutional Court is the highest authority which protects and guaranties the implementation of the Constitution. However, the sphere of competencies of this Court in dealing with individual complains is limited. The Constitutional Court decides for the final judgements of an individual complaint on violations of the constitutional rights of ‘*due process*’, after other judicial means for the protection of such rights have been exhausted.

In the case *Qufaj & Co v. Albania*, the ECtHR has assessed that the right of individual complaint before the Albanian Constitutional Court can be considered an effective remedy, the exhaustion of which is required according to Article 35 of the Convention when Article 6 issues arise. However, there are still debates about the effectiveness of the Constitutional Court as an effective remedy according to Articles 13 and 35/1 of the ECHR. Considering non-execution of final court judgments as an element of the fair trial, it might be arguable whether the Constitutional Court fulfils the criteria of an effective remedy not only *de jure* but also *de facto*. So far, the Constitutional Court must find the possibility to be effective in such cases, where the non-execution of final decisions becomes an issue.

**Keywords:** Effective application, Constitutional Court, legal remedy, solution.